



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 29 shtator 2015, në mbledhjen e pestë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.05

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Radisav Perović , përfaqësues i Komunitetit serb; z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit për Komunitete; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Nexhmi Rudari, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Sami Ajeti, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit në Nivel komunal; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z. Faik Muçiqi, përfaqësues i Emergjencave Civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim; z. Bunjamin Hoti, përfaqësues i OJQ-ve; z.Fadil Halimi, përfaqësues i Mediave lokale; z.Avni Shabani, përfaqësues i Komunitetit të biznesit dhe z. Idriz Hoxha, përfaqësues i komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa mungoi:z. Bekim Bislimi, Komandant i Stacionit të Policisë dhe z. Bekim Jashari, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: znj. Valbona Blakqori, togere, Zëvendëskomandante e Stacionit të Policisë në Podujevë; z.Nylias Gergo,shef i LMT-së; përfaqësuesë të OSBE-së; përfaqësues të Zyrës së UNMIK-ut.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, ju përshëndes të gjithëve, mirë se keni ardhur, më lejoni të hapi mbledhjen e KKSB-së, materialet për rendin e punës besoj se i keni marrë me kohë. Nëse jeni dakord mund të fillojmë me këtë rend pune.

1. Rend i propozuar i ditës

U miratua njëzëri.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 03 qershor 2015 dhe 22 korrik 2015

Ekstaraktet e procesverbaleve u miratuan njëzëri

3. Raporte të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it për gjendjen e sigurisë në Komunë

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka znj. Valbona Blakqori, togere, zëvendëskomandante e Stacionit të Policisë në Podujevë, e cila zëvendëson Komandantin e Policisë dhe do të na informojë për gjendjen e sigurisë në Komunë.

znj. Valbona Blakqori, togere, theksoi, jam zëvendëskomandante e Stacionit të Policisë në Podujevë. Aktualisht Komandanti është në pushim vjetor dhe e zëvendësoj në këtë takim. Unë kam përgatitur një raport statistikor për tremujorin e dytë të vitit 2015 dhe atë të vitit 2014, në periudhën e njëjtë për të bërë krahasimet. Pas shqyrtimit të analizës së këtij raporti vërehet se kemi rënie të rasteve të raportuara. Në vitin 2014 në të njëjtën periudhë i kemi pasur 470 raste, ndërsa në periudhën e njëjtë

të vitit 2015 kemi pasur 334 raste, pra 136 raste më pak. Te kategoria e veprave penale te vjedhjet dhe vjedhjet e rënda kemi pasur reduktim të rasteve diku rreth 50 %, e gjithë kjo rezulton nga angazhimi i policisë, qytetarëve që kanë kontribuar në dhënien e informatave dhe akterëve të tjerë që kontribuojnë në gjendjen e sigurisë. Në raport mund të vëreni edhe dy shifra (6 dhe 15) ku kanë të bëjnë me rastet të cilat janë transferuar prej Njesisë së Policisë Kufitare. Gjatë verës kemi qenë të ngarkuar, kemi asistuar në aktivitete të institucioneve qeveritare dhe joqeveritare si dhe të organizatave të ndryshme mirëpo kemi pas edhe numrin e madh të bashkatdhetarëve, që ka reflektuar angazhim të shtuar pastaj dasmat që kryesisht janë mbajtur gjatë muajit gusht, ku me këtë rast Policia ka hartua planet operative për parandalimin e shtënave me armë nëpër dasma. Nuk mund të themi se nuk ka pas të shtëna me armë , mirëpo ne kemi hartuar planin operativ dhe kemi konfiskuar 26 armë gjatë këtyre dasmave, 31 municione të ndryshëm, 11 gëzhoja si dhe 16 persona janë arrestuar dhe janë dërguar para gjykatave kompetente për shkak të rrezikut të përgjithshëm, apo armëmbajtjes pa leje nëpër dasma. Kemi pas intervenime edhe nëpër lokale të ndryshme të cilat gjatë sezonit të verës kanë bërë prishjen e rendit dhe qetësisë publike por edhe për mosrespektim të orarit të punës ku në çdo thirrje të qytetarëve policia ka reagua dhe ka ndërmarrë masat e duhura. Te lokalet që nuk kanë respektuar orarin e punës iu është bërë fletëparaqitje për mos respektim të orarit duke proceduar lëndët te inspektorët komunal, ndërsa te rastet ku është bërë prishja e rendit dhe qetësisë publike rastet janë proceduar në gjykatë. Gjatë kohës së fundit kemi marrë ankesa të shumta prej qytetarëve për shkak të rrezikut nga qentë endacak. Ne jemi të vetëdijshëm se ekziston ligji për mbrojtjen e kafshëve, mirëpo megjithatë duhet bërë diçka në këtë drejtim në mënyrë që mos të kemi ndonjë rast, të pësojnë qytetarët, në këtë drejtim duhet bërë diçka bashkërisht . Po ashtu kemi hartuar një projekt me vet iniciativën e Policisë për identifikimin problemeve në shkolla dhe rreth tyre. Kemi bërë disa identifikime nëpër shkolla, qoftë rrethoja dhe rreziqet të cilat paraqiten përreth shkollave. Nuk po i përmend në detaje veç e veç por kjo do të i përcillet drejtorit të Drejtorisë së Arsimit.

Pasi viti shkollor ka filluar, sikurse edhe viteve të tjera ne kemi zyrtar policor të cilët janë të caktuar nëpër shkolla në rroba civile, ku falë tyre por edhe bashkëpunimit të ngushtë me drejtorë të shkollave nuk është shënuar asnjë incident vitin e kaluar dhe shpresoj se do të kemi prapë bashkëpunim dhe koordinim të veprimeve, në mënyrë që ta kemi situatën e duhur nëpër shkolla. Në ditët në vijim nuk kemi marrë ndonjë informacion që do të ndikojë në çrregullimin e rendit dhe qetësinë publike, mirëpo ne do të vazhdojmë me punët tona të përditshme në parandalimin e krimit. Falënderoj Kryetarin e Komunës për bashkëpunimin por edhe Bashkësinë Islame që kohën e fundit kemi pas një koordinim më të theksuar të punëve dhe aktiviteteve. Po ashtu falënderoj edhe mediat të cilat na japin mundësinë që ne si Polici ta prononcojmë punën tonë të përditshme. Nuk kam diçka tjetër për të shtuar, nëse ka ndonjë pyetje lidhur me raportin jam në dispozicion të përgjigjem.

z.Nylas Gergo,shëf i LMT-së, sa i përket situatës së sigurisë, nga ana e KFOR-it, Podujeva është dhe shpresoj të mbetet një nga rajonet më të qeta në Kosovë. Dua të falënderoj shërbimet e sigurisë, Policinë dhe institucionet e ndryshme të Komunës për bashkëpunim që kemi me to dhe bashkërisht do të tentojmë ta mbajmë këtë situatë. Ju falënderoj për vëmendjen, shkurtimisht kjo është e tëra, nëse keni ndonjë pyetje mund të shtroni lirisht.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, faleminderit për raportet e paraqitura, e hap mundësinë për debat, nëse keni ndonjë pyetje, koment apo sugjerime.

z. Idriz Hoxha, theksoi, kam një vërejtje lidhur me pamundësinë e parkimit të automjeteve të personave me nevoja të veçanta, në parkingjet e përcaktuara me shenja të komunikacionit për persona me nevoja të veçanta, me theks te parkingu pran Stacionit të Policisë. Në atë vend ka tre muaj që nuk na lejohet parkimi i veturave të personave të kësaj kategorie. Ndërsa te shenjat që është e rezervuar për parkim të automjeteve për persona me nevoja të veçanta parkohen edhe automjete të tjera. Do të pyesja Zëvendëskomandanten se pse nuk po na lejohet parkimi i automjeteve në vend parkingun e cekur.

znj. Valbona Blakqori, togere, shenja është në vendin që theksoi parafolësi. Ne kemi shumë respekt për personat me nevoja të veçanta. Kërkesë e jona është që s'paku në automjetet e tyre ti vendosin shenjat. Sa i përket vërejtjes së parafolësit ne nuk kemi pas asnjë ankesë nga kjo kategori e personave me nevoja të veçanta, për mos lejim nga ana e policisë për parkimin e automjeteve pranë shenjave të rezervuara për këtë kategori të personave, apo që kanë qenë të bllokuara parkingjet nga persona të tjerë, asnjëherë nuk kemi pas kurrfarë informacioni të tillë. Përveç kësaj është e padrejtë kur theksohet se ka tre muaj kjo kategori e personave nuk ka mundur të parkojë automjetet kur unë personalisht

javën e kaluar kam pas kontakt me një person që pikërisht vjen dhe e parkon automjetin në vendin në fjalë, që dmth. nuk ka pas kurrfarë ankese se ai ka problem rreth parkingut. Në parkingjet e rezervuara për këtë kategori të qytetarëve nuk u lejohet as policëve që të parkojnë automjetet, nëse keni ankesa të tilla është mirë të paraqiten në Polici dhe ne do të merremi me zgjidhjen e problemit

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, me Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike bashkërisht edhe me Policinë do të merremi me zgjidhjen e kësaj çështjeje, do t'i caktojmë vendet më të përshtatshme për parkimin e automjeteve të personave me nevoja të veçanta.

Nëse nuk keni diçka për të shtuar unë e përmbylli këtë pikë të rendit të ditës. Edhe njëherë falënderojmë përfaqësuesen e Policisë dhe atë të KFOR-it për raportimet e bëra. Sigurisht edhe në këtë takim me kënaqësi po konstatojmë se numri i veprave të ndryshme penale është në rënie edhe më tutje. Për periudhat raportuese vërehet një dallim i madh i numrit të veprave, me përjashtim ku disa rezultojnë në rritje, por në total numri është në rënie. Urojmë që ky trend të vazhdojë me rënie dhe sigurisht meritë të veçantë ka Policia e Kosovës dhe institucionet në përgjithësi por edhe ngritja e vetëdijes së qytetarëve.

Kalojmë në pikën e radhës

1. Informatë e Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit për intervenimet gjatë sezonit veror 2015

Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fjalën e ka z. Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit

z. Faik Muçiqi, raporti përfshinë periudhën verore, mirëpo sa për informim Shërbimi i Zjarrfikësve nga muaji janar deri në shtator ka intervenuar në 410 raste dhe krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ku kemi pas 316 rezultojnë në 29.7 % më shumë intervenime edhe pse deri në fund të qershorit koha ka qenë me shira. Kryesisht muaji korrik e gusht me ngritje të temperaturave ka ndikua në shkaktimin e zjarreve të ndryshme dhe si rrjedhojë shtimin e intervenimeve. Në bazë të raportit të intervenimeve mund të themi se dëmet janë kryesisht në pyje, përafërsisht 31 ha, që krahasuar me vitin e kaluar është një rënie por sigurisht edhe pyjet pak a shumë janë zvogëluar, pastaj fusha, hamullore, barë të thatë dhe kullosa 227 ha që është shqetësimi i madh. Fatkeqësisht ende vazhdon djegia e hamulloreve, fushave e të tjerave. Me gjithë fushatën që është bërë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural por edhe nga Policia që hamulloret janë të dëmshme për djegie, megjithatë në vende të ndryshme kanë bërë djegien e tyre. Sa i përket numrit të intervenimeve në qershor kanë qenë 11 intervenime të cilat kanë qenë kryesisht gjatë kohës së reshjeve të shiut, nuk ka pas intervenime të zjarreve, kanë qenë kryesisht të aksidenteve, në komunikacion, në korrik 113 intervenime, gusht 71 intervenime dhe shtator deri në javën e kaluar kanë qenë 51, gjithsejtë 246 intervenime. Shërbimi i Zjarrfikësve ka qenë i përgatitur në fillim të vitit me numrin e punëtorëve dhe pajisjeve të tjera. Me kërkesë të Kryetarit të Komunës jemi pajisur me dy automjete të reja nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga Komuna simotër Westershtede e Gjermanisë gjithashtu kemi donacion një automjet. Me pajisje jemi kryesisht mirë, por kemi problem ende me numrin e punëtorëve meqenëse problemi i shërbimit të zjarrfikësve është aktual dhe për faktin jo ende i trajtuar në nivelin që duhet të jet. Edhe këtë vit është dashur me dy punëtorë sezonal të ndihmojmë Shërbimin por edhe resori i pyjeve gjithashtu ka ndihmuar me tetë punëtorë që kanë shërbyer si ndihmës dhe kanë qenë në komandën e përbashkët me Shërbimin e Zjarrfikësve. Këto janë kryesisht të dhënat e Shërbimit të Zjarrfikësve. Ajo çka mbetet shqetësuese është dënimi tepër i vogël i rasteve të zjarrvënive.

Shërbimi i Zjarrfikësve që nga muaji korrik deri te fundi i muajit gusht te Liqeni i Batllavës ka patrullime shtesë për shkak të shtimit të numrit të vizitorëve, posaçërisht gjatë vikendit ka shumë vizitorë dhe ekipi ka qenë gjithherë prezentë dhe vizitorëve u ka dhënë udhëzimet e nevojshme.

Agim Veliu, Kryetar i Komunës, Shërbimit të zjarrfikësve i dëshirojmë sa më pak punë dhe kërkojmë nga qytetarët të mos ketë zjarrvënie të qëllimshme si në hamullore, pyje etj. Është mirë që Brigada e Zjarrfikësve pak a shumë është stabilizuar për sa i takon pajisjeve, me këto automjete që janë dhënë nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe një si donacion por mbetet ende shqetësim për ne numri ende i vogël i punëtorëve në këtë Brigadë për arsye se Komuna Podujevës është komuna më e madhe me territor në Republikën e Kosovës, ndërsa me numër të punëtorëve radhitet në mesin e komunave më të vogla apo të mesme. Për këtë duhet biseduar me kompetentët, por nga ky takim me ngritë edhe njëherë si shqetësim me kërkuar që Brigada të forcohet por ndoshta të mendojmë edhe për aplikimin e formës së përkrahjes vullnetare që fatkeqësisht te ne ende nuk ka filluar të aplikohet,

ngase ka vullnetarë që janë të gatshëm dhe ne si institucion me ndërmarrë masat që ata që dëshirojnë të jenë pjesë e Brigadës me i liruar edhe prej punëve tjera ashtu sikurse është e rregulluar edhe në vendet tjera, në Evropë dhe është mirë që këtë projekt të iniciojmë përmes Drejtorisë përkatëse. Duhet biseduar me përfaqësues të lagjeve urbane dhe të fshatrave për të ngritur vetëdijen e solidarizimit në rastet e paraqitjes së zjarreve apo fatkeqësive tjera elementare, ngase jemi dëshmitarë që presin vetëm intervenimet e shërbimeve komunale pa shprehur interesim dhe vullnet që të marrin iniciativë dhe të kontribuojnë në raste të tilla dhe të mos pritët vetëm prej institucionit se është e pamundur të arrihet me kohë duke marrë parasysh distancën apo shtrirjen gjeografike të vendbanimeve. Në këtë drejtim kërkoj të punohet më tepër.

Faleminderit, më lejoni të kalojmë në pikën e radhës.

5. Gjendja e rrjetit elektroenergjetik në territorin e Komunës së Podujevës

Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fjalën prapë e ka z. Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së SHPMSH z. **Faik Muçiqi,** e kemi paraparë këtë temë për arsye, siç e dini rrjeti elektroenergjetik si në përgjithësi në Kosovë edhe në komunën tonë është i vjetruar, posaçërisht në fshatra dhe është mjaft i rrezikshëm. Kemi pas raste sidomos gjatë vërshimeve dhe erërave kur shumë shtylla kanë rënë. Megjithatë plani investiv ka filluar në komunën tonë, janë bërë disa ndërhyrje në rrjet, kryesisht janë në Qytet por jo në fshatra. Kanë investuar në disa trafostacione sepse ku është edhe rrjeti i vjetruar ka qenë edhe tensioni i ulët. Në shumë lagje dhe fshatra ka qenë kapaciteti i dobët i rrymës. Në Qytet po i vendosin shtyllat e betonit, mirëpo në fshatra ende jo me përjashtim të disa prej tyre ku i kanë ndërruar trafostacionet. Kërkesat dhe ankesat janë të shumta. Kemi vërejtje që rrjeti i vjetër është duke u çmontuar ngadalë, kemi kërkuar që kjo të bëhet më shpejtë. Drejtoria çdo kërkesë të tyre për dhënie të pëlqimit, e ka miratuar me kohë. Dukuri që nuk ka hasur në përkrahje ka qenë kushtëzimi për vendosjen e njësorëve elektrik Vendosja e njësorëve ka qenë një politikë e keqe që të investohet, apo ndoshta pak a shumë edhe për t' i arsyetuar obligimet e tyre që i kanë në rrjet. Insistohet që rrjeti të zgjerohet në fshatra dhe të zëvendësohet pasi që është shumë i vjetruar, ku ka kërkesa dhe shqetësime të shumta të banorëve, shtyllat të ndryshohen dhe trafostacionet të përmirësohen aty ku ka nevojë, ndërsa në Qytet të orientohen investimet e shtrirjes së rrjetit nëntokësor.

Agim Veliu, Kryetar i Komunës, a ka dikush diçka rreth informatës së paraqitur nga Drejtori.

z. Fadil Halimi, theksoi, jemi dëshmitarë se Komuna e Podujevës është ndër komunat më të diskriminuara në Kosovë sa i përket furnizimit me energji elektrike. Edhe gjatë sezonit të verës ne kemi pasur reduktime të shumta të energjisë elektrike. Sipas kategorizimit Komunën e Podujevës e kanë ranguar në kategorinë (c), kjo si rezultat i ekzekutimit të pagesave ndaj KEDS-it. Nuk kam njohuri për shifrat por bazuar në radhët e pritjes së qytetarëve për kryerjen e obligimeve të veta, nuk e shoh se si mund të jemi Komuna më e dobët sa i përket kryerjes së pagesave. Po ashtu problem shumë shqetësues është siç e potencoi Drejtori shtyllat e vjetruara dhe të kalbura. Kjo gjendje është e theksuar më tepër nëpër fshatra. Bien telat e rrymës dhe rrezikohen qytetarët.

Agim Veliu, Kryetar i Komunës, është e vërtetë se ne si Komunë na kanë përcjellë probleme me Kompaninë e distribuimit të energjisë elektrike edhe përpara edhe tash me KEDS-in. Këtë problem e kemi diskutuar disa herë. Është mirë që kohën e fundit kanë filluar pak a shumë të kemi mirëkuptim sepse definitivisht e kanë vërejt se Komuna e Podujevës është në mesin e Komunave të diskriminuara, nuk e di nëse ka edhe të tjera, për sa i takon furnizimit me energji edhe për sa i takon investimeve në Komunë. Ne ende në Qytet kemi shtylla të vjetruara, të drurit dhe atë në rrugët kryesore të Qytetit, me shumë tela që paraqesin rrezikshmëri për banorët, andaj e kemi vlerësuar se është mirë ta diskutojmë këtë çështje edhe në KKSB në mënyrë që të dalim me një konstatim dhe kërkesë edhe nga ky takim. Rrjeti është i vjetruar, është rrjet që paraqet rrezik për banorët në disa mese, tensioni është i ulët, dmth. Është nën minimumin e nivelit të paraparë edhe pse tensioni duhet të jetë përherë në nivelin e duhur, për të kryer punë edhe amvisëritë dhe ata që merren me biznes. Si ndërprerja ashtu edhe tensioni i ulët i energjisë elektrike, po shkaktojnë prishje të ndryshme edhe të pajisjeve shtëpiake edhe dëme në biznese. Ka qenë këtu një praktikë e keqe por pasi që e kemi diskutuar disa herë me Kompaninë gjendja pak u relaksua sa i përket ndërprerjes së energjisë për institucionet edhe pse u kemi tërheqë vërejtjen se ne i kemi alokimet e buxhetit periodike, në tre muaj, katër muaj edhe se jeni të sigurt se te ne i keni pagesat ata prapë se prapë e kanë ndërprerë edhe në shtëpi të shëndetit edhe nëpër shkolla, Komunë edhe Çerdhe. E theksoj se pas disa bisedave kjo pak është relaksua edhe pse kemi prapë raste, kështu që nga ky takim nëse jeni dakord bashkërisht dalim me një konstatim se kjo është gjendja dhe kërkesa është që të intervenohet sa më shpejtë, fillimisht të

zëvendësohen shtyllat që paraqesin rrezik, pas vlerësimit të rrezikshmërisë, e pastaj duke vazhduar në eliminimin e tyre në tërësi. Në Qytet është mirë të mos mendohet më për shtylla. Kompanisë i kam ofruar të bashkëngjiten gjatë realizimit të projekteve, u kam ofruar disa herë që të kenë listën e projekteve të cilat i planifikojmë qoftë për trotuare, për kanalizime e për çka do qoftë që ne punojmë në Qytet, atyre tiu mundësohet vetëm për t'i vendosur gypat apo kabllot pa bërë pagesë të punëve të gërmimit dhe punëve të tjera që ndërlidhen, në kuadër të projekteve që realizon Komuna kudo, por në Qytet me përparësi, kështu që nëse jeni dakord dalim me një konstatim dhe kërkesë në emër të KKSB-së, duke iu drejtuar edhe njëherë KEDS-it për mirëkuptim.

Kalojmë pikën e radhës.

6. Ndriqimi publik në qytet

Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fjalën e ka z. Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së SHPMSH

z. Faik Muçiqi, theksoi, faktikisht kjo është si nënpikë e temës paraprake, kjo në një mënyrë është një segment që i kontribon sigurisë. Ne kemi ndriqim publik në 38 rrugë të Qytetit me gjatësi 34.5 m. Në Qytet ende kemi rrugë që nuk janë të ndriçuara, mirëpo shpresojmë që vitin e ardhshëm ti përfundojmë. Këtë vit është investuar me 65,000 € në zgjerim të rrjetit brenda Qytetit dhe 50,000 € nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa vitin e ardhshëm vetëm për Qytet kemi paraparë rreth 50,000 € buxhet për përfundimin e rrjetit. Dua të theksoj se ka shumë vjedhje dhe thyerje të poqeve elektrik, ka edhe raste të aksidenteve që ndodhin dhe dëmtojnë shtyllat, e që disa rrugë janë indikative pse ndodhin ato, ngase në ato rrugë paraqiten thyerje apo mungesë e tyre vazhdimisht. Qytetarët kanë shqetësimet e tyre se sigurisht në ato rrugë ka edhe vjedhje më të shpeshta. Aty ku ka munguar ndriqimi vjedhjet kanë qenë më të mëdha në Qytet. Në Qytet shtylla të metalit për ndriqim i kemi 107, shtylla të drurit 478 dhe 97 janë të betonit, pra janë 667 trupa ndriques në Qytet. Vitin e kaluar dhe këtë vit kemi përfunduar ndriqimin solar në Qytet, për herë të parë kemi shkuar me një ndriqim të avancuar dhe deri më tani jemi të kënaqur me punën e këtij ndriqimi, ngase në Kosovë kemi pas shumë dilema rreth këtij ndriqimi solar, ngase standardi i punimeve ka qenë më i lartë. Me këtë ndriqim kemi rrugët “Zahir Pajaziti”, “Skënderbeu”, “Liria” dhe këto ulin shpenzimet e pagesës së ndriqimit.

Drejtori në vazhdim foli për investimet dhe planifikimet rreth ndriqimit për rrugët veç e veç ku planifikohet zgjerimi i ndriqimit. Nënvizoi, tani më do të ndryshohet edhe struktura e buxheteve, ngase tani ne kalojmë prej asaj të investimeve në strukturën e mirëmbajtjes dhe shërbimeve dhe si rrjedhojë sikurse çdo komunë kemi probleme me buxhetin për mallra e shërbime ku duhet paguar shpenzimet e ndriqimit, por kjo domosdoshmërisht duhet ndryshuar ngase Komuna nuk është duke i përballuar shpenzimet jo vetëm të ndriqimit por edhe shërbimet tjera të rrugëve, të mirëmbajtjeve etj, prandaj ndërrimi i strukturës së buxhetit neve na mundëson që të zgjerohemi edhe në periferi, ngase kjo është e drejtë e qytetarëve, posaçërisht në fshatrat që i kemi pran Qytetit. Nuk është shumë i lartë shpenzimi investiv, Komuna mund të përballojë shpenzimin investiv, por nuk mund të përballojë shpenzimet komunale tani për tani me buxhetin komunal. Ndriqimet e fundit janë me standarde të reja, pra qëllimi është të kalojmë në ndriqime me shpenzime sa më të pakta, më racionale. Shpresojmë që vitin e ardhshëm ta përfundojmë Qytetin.

Agim Veliu, Kryetar i Komunës, faleminderit, a ka dikush diçka. Për sa i takon këtij aspekti të eficiencës ne si Komunë kemi bërë përpjekje me ecë përpara dhe besoj se kemi arritë diçka, kemi hartuar edhe strategji të ndryshme për sa i takon kësaj fushe dhe kemi qenë vazhdimisht të përkushtuar edhe me buxhet edhe me donatorë të ndryshëm që punojnë në këtë drejtim jo vetëm në ndriqimin publik por edhe në disa objekte shkollore etj. dhe si rezultat i kësaj Komuna e Podujevës është përzgjedhë si Komunë e cila do të nënshkruaj Konventën e Kryetarëve të Komunave në Bruksel më 15 tetor 2015. Unë do të udhëtoj atje dhe do të jem njëri prej atyre që do të nënshkruaj këtë Konventë sepse jemi përzgjedhë në mesin e një apo dy Komunave të Kosovës dhe sigurisht do të na hapen edhe mundësi tjera sa i takon këtij aspekti.

Nëse dikush nuk ka diçka për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

7. Të ndryshme

z. Shaban Ahmeti, theksoi, falënderoj Komunën, përkatësisht Drejtorinë e Arsimit që ka mundësuar furnizimin pa pagesë të 70 kompletë libra për nxënësit e shkollave të mesme për komunitet pakicë.

Kryetari përfundoi mbledhjen pasi që nuk pat çështje tjera për shqyrtim, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën 11.15

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani

Nr. 02-006-92112

Podujevë,

29 shtator 2015

Kryetari i Komunës

Agim Veliu